



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac / Municipality of Rahovec
KUVENDI I KOMUNËS / SKUPŠTINA OPŠTINE / MUNICIPAL ASSEMBLY

RAHOVEC / ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01 (Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/23 Nr. i faq./Br.str./No.pg 35

Data / Datë / Date 28.02.2023

Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 28.02.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e fushës sintetike për Klubet e Futbollit në Komunën e Rahovecit

1. Me këtë vendim **caktohet** lokacioni për ndërtimin e fushës sintetike për Klubet e Futbollit në Komunën e Rahovecit.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01015-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 28918m² (njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë metra katror), zona kadastrale Xërxë, e evidentuar në posedim të KK.RAHOVEC DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen 13800m² (trembëdhjetë mijë e tetëqind metra katror) për ndërtimin e fushës sintetike për Klubet e Futbollit në Komunën e Rahovecit.
4. Fusha sintetike e cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të shfrytëzohet nga të gjitha klubet e futbollit të licencuara pranë Federatës së Futbollit të Kosovës.
5. Prona e paluajtshme nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019

për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport,**
- **Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe**
- **Arkivi.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01 Nr.35/23
Me datë:28.02.2023

